



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E APELIT TIRANË

Numri i Çështjes	11232-00732-30-2018	Data e Regjistrimit	3/5/2018
Numri i Vendimit	30-2019-354	Data e Vendimit	2/5/2019

VENDIM NE EMER TE REPUBLIKËS

GJYKATA E APELIT TIRANË E PERBERE NGA:

KRYESUES: Asim Vokshi
ANËTAR Fatri Islamaj
Shpresa Becaj

SEKRETARE ZANA DISHA

Objekti: Rishikimin e Vendimit Nr. 12910, dt. 23.12.2003 te Gjykeses se Rrethit Gjyqesor Tirane, lene ne fuqi me Vendimin Nr. 3891, dt. 01.12.2014 te Gjykeses se Apelit Tirane.

Baza Ligjore : Nenet 494, 496, 498, 498/a te K.Pr.Civile.

Përmbledhja e vendimit:

Gjykata e Apelit Tiranë pasi shqyrtoi çështjen, administroi provat në seancë gjyqësore, dëgjoi pretendimet e palës kërkuese e cila kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit, dhe të paditurit që kërkuan mospranimin e kërkesës për rishikim vendimesh,

VËREN:

I. RRETHANA PROCEDURALE

1. Rezulton se kërkuessit e sipërcituar i janë drejtuar fillimisht me këtë kërkesë për rishikim vendimi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr.990, datë: 07.02.2018 ka vendosur: “*Shpalljen e moskompetencës së shqyrtimit të kësaj çështje prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Apelit Tiranë.*” Më datë 07.03.2018 çështja është shortuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke u caktuar gjyqtarja relatore Zegjine Sollaku, e cila më datë 20.04.2018 i ka paraqitur kryetarit të gjykatës kërkesë për heqje dorë nga gjykimi pasi ka marrë pjesë në dhënien e vendimit nr.3891, datë: 01.12.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, objekt rishikimi. Me vendimin nr.226.prot, datë: 24.04.2018 të Kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, është pranuar dorëheqja e gjyqtares së mësipërme dhe çështja është rihedhur në short. Më datë 26.04.2018 pas shortit elektronik çështja i ka kaluar gjyqtarit relator Gjini Gjoni. Nga ky moment deri më datë 29.10.2018 çështja nuk është vënë në lëvizje nga gjyqtari relator.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT TIRANË

2. Më datë 29.10.2018 çështja është rishortuar dhe i ka kaluar gjyqtarit të ri relator Asim Vokshi, i cili duke vlerësuar se kjo ishte një çështje me natyrë urgjente, e ardhur për kompetencë nga gjykata e shkallës së parë Tiranë, që nuk lidhej me shqyrtimin normal të çështjeve me ankim sipas radhës, por shqyrtohej si shkallë unike, në bazë të një procedure të posaçme ligjore, procedoi menjëherë me vënien në lëvizje të saj, duke caktuar seancën gjyqësore më datë 05.12.2018, e duke qenë se anëtarja e trupit gjykues e paraplanifikuar ishte gjyqtarja Maria Qirjazi, e cila edhe ajo kishte të njëjtin shkak përjashtimi si gjyqtarja Zegjine Sollaku pasi kishte marrë pjesë në dhënien e vendimit nr.3891, datë: 01.12.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, objekt rishikimi, për të shmangur zvarritjen e gjykimit u procedua me kërkesë për plotësimin e trupit gjykues, e cila u pranua dhe trupi gjykues u plotësua me gjyqtaren Shpresa Beçaj, krahas gjyqtarëve Fatri Islamaj e Asim Vokshi. Në seancën e datës 05.12.2018 pala kërkuese kundërshtoi qenien e gjyqtares Shpresa Beçaj në përbërje të trupit gjykues, pasi kjo gjyqtare ka marrë pjesë në dhënien e vendimit nr.1026, datë: 19.07.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila lidhet me këtë mosmarrëveshje, sepse ka të bëjë me padinë për pavlefshmërinë e titujve ekzekutivë (*vendimeve objekt i kërkesës për rishikim*) të ngritur nga paditësit Dervishi dhe Llapaj. Në këto kushte kjo gjyqtare i paraqiti dorëheqjen kryetarit të gjykatës i cili me vendimin nr.721.prot, datë: 07.12.2018 e pranoi atë. Më tej trupi gjykues u plotësua me short me gjyqtarin Gramoz Levanaj dhe çështja u shqyrtua më datë 30.01.2019, duke i dhënë zgjidhje përfundimtare.

II. Faktet e çështjes

3. Rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.12910, datë: 23.12.2013, ka vendosur:

- *“Pranimin e pjesshëm të padisë së paditësave Aleksandër Gavoçi dhe Ilir Gavoçi.*
- *Detyrimin e të paditurve Fatime Dervishi, Ramazan Dervishi, Ramiz Dervishi dhe Sinan Dervishi, t’u lirojnë dhe dorëzojnë paditësave sipërfaqen 210.75m², truall pronë e tyre, ndodhur në Tiranë, Rruga “Sami Frashëri”, përballë Institutit nr. 3.*
- *Detyrimin e të paditurve Agron Llapi, Bukurije Llapi, Dhurata Llapi dhe Luan Llapi, t’u lirojnë dhe dorëzojnë paditësave sipërfaqen 125 m², truall, pronë e tyre, ndodhur në Tiranë, Rruga “Sami Frashëri”, përballë Institutit nr. 3.*
- *Detyrimin e të paditurve Fatime Dervishi, Ramazan Dervishi, Ramiz Dervishi dhe Sinan Dervishi, të prishin me shpenzimet e tyre, ndërtimet mbi katin përdhe të banesës së tyre ndodhur në Tiranë, Rruga*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT TIRANË

“Sami Frashëri”, Pall. 33, Shk. 1, kati i parë, me sipërfaqe 107.30 m2.

- *□□□□□□□□ Detyrimin e të paditurve Agron Llapi, Bukurije Llapi, Dhurata Llapi dhe Luan Llapi, të prishin me shpenzimet e tyre ndërtimet mbi katin përdhe të banesës së tyre ndodhur në Tiranë, Rruga “Sami Frashëri”, Pall. 33, Shk. 1, kati i parë, Ap. 33, me sipërfaqe 116 m2.*
- *□□□□□□□□ Detyrimin e të paditurve Fatime Dervishi, Ramazan Dervishi, Ramiz Dervishi dhe Sinan Dervishi, t’u paguajnë paditësave shumën 15,951,087 (pesëmbëdhjetë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e një mijë e tetëdhjetë e shtatë) Lekë, e cila përbën vlerën e të ardhurave të sendit, “truall” me sipërfaqe 210.75 m2, në pronësi të paditësave, nga data 12.11.1997 (dita e paraqitjes së padisë), deri në datën 08.10.2013 (dita e shtesës së aktit të ekspertimit).*
- *□□□□□□□□ Detyrimin e të paditurve Agron Llapi, Bukurije Llapi, Dhurata Llapi dhe Luan Llapi, t’u paguajnë paditësave shumën 13,579,980 (trembëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntëmijë e nëntëqind tetëdhjetë) Lekë, e cila përbën vlerën e të ardhurave të sendit, “truall” me sipërfaqe 125 m2, në pronësi të paditësave, nga data 12.11.1997 (dita e paraqitjes së padisë) deri në datën 08.10.2013 (dita e shtesës së aktit të ekspertimit).*
- *□□□□□□□□ Rrëzimin e pjesës tjetër të objektit të padisë në lidhje me vlerën e të ardhurave të sendeve truall, të përdorura nga të paditurit Agron Llapi, Bukurije Llapi, Dhurata Llapi, Luan Llapi dhe Fatime Dervishi, Ramazan Dervishi, Ramiz Dervishi, Sinan Dervishi.*
- *□□□□□□□□ Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të paditurve.”*

4. Vendimi i mësipërm i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është lënë në fuqi me vendimin nr.3891, datë: 01.12.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Këto dy vendime janë objekt i kërkesës për rishikim vendimi, të paraqitur nga kërkuesit Llapaj dhe Dervishi. Rezulton se këto palë, e konkretisht shtetasit Luan Llapaj dhe Ramazan Dervishi, kanë pas paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë ndaj vendimit nr.3891, datë: 01.12.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, porse kanë hequr dorë nga rekursi i bërë, e për rrjedhojë Gjykata e Lartë me vendimin nr.1934, datë: 05.06.2015 ka vendosur: “*Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur Luan Llapaj dhe Ramazan Dervishi, kundër vendimit nr.3891, datë: 01.12.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak të heqjes dorë nga rekursi.*”

5. Siç kuptohet nga përmbajtja e shkresës nr.846/2.prot, datë: 19.03.2018 e Drejtorisë së ALUIZNI-t Tirana Jug (*sjellë si provë nga i padituri në këtë gjykim*), shkak i heqjes dorë nga rekursi të Ramazan Dervishit dhe Luan



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT TIRANË

Llapajt, lidhej me lëshimin nga ana e kreditorëve Ilir dhe Aleksandër Gavoçi të deklaratës noteriale nr.2892.rep, nr.1156.kol, datë: 18.05.2015, me të cilën ata kanë hequr dorë nga ekzekutimi i titullit ekzekutiv vendimi nr.12910, datë: 23.12.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.3891, datë: 01.12.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

6. Më datë 26.01.2018 kërkuesit Llapaj dhe Dervishi i janë drejtuar me kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt “Rishikimin e vendimit nr.12910, datë: 23.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.3891, datë: 01.12.2014 nga Gjykata e Apelit Tiranë.” Shkaku i vetëm për të cilin këta shtetas kërkojnë rishikimin e vendimeve të mësipërme gjyqësore është se sipas tyre, më datë 24.01.2018 ata kanë marrë dijeni për shkresën nr.8141/1, datë: 28.12.2017 të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave Informale, me anën e të cilës shtetasve Luan Llapaj dhe Ramazan Dervishi ju është miratuar e drejta e kalimit të pronësisë me VKM nr.1283, datë: 23.12.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.195 të atij viti. Në fakt në faqen 8668 të kësaj Fletoreje Zyrtare gjendet edhe emri i Luan Llapaj dhe Ramazan Dervishi. Në këto kushte kërkuesit pretendojnë se kanë ardhur në dijeni të një fakti të ri me shkrim që nuk dihej në momentin që zhvillohej gjykimi dhe për këtë shkak kërkojnë rishikimin e vendimeve të formës së prerë objekt kërkesë. Sipas kërkuesve VKM nr.1283, datë: 23.12.2009 hedh poshtë zgjidhjen e bërë nga gjykatat, e për këtë shkak vendimet e tyre duhen rishikuar.

7. Shkresa nr.8141/1.prot, datë: 28.12.2017 e pretenduar nga kërkuesit së përbën faktin e ri, është një dokument “kthim përgjigje” i Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t për Drejtorinë e ALUIZNI-t Tiranë Jug, në bazë të shkresës së kësaj të fundit nr.4123.prot, datë: 28.12.2017.

III. Ligji i zbatueshëm

8. Neni 494 Kodit të Procedurës Civile parashikon se:

“Kërkesa për rishikim është akti me të cilin kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës.

Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur:

a) zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj;

b) vërtetohet se thëniet e dëshmitarëve apo mendimet e ekspertëve, mbi të cilat është bazuar vendimi, kanë qenë të rreme;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT TIRANË

c) palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit;

ç) vërtetohet se vendimi i dhënë është bazuar në dokumente të falsifikuara;

d) vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës ose të një institucioni tjetër që më pas është prishur;

e) vendimi është në kundërshtim të hapur me një vendim tjetër të formës së prerë të dhënë midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak.

ë) kur Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.”

9. Neni 496 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se:

“Kërkesa për rishikim mund të paraqitet brenda 30 ditëve nga dita që pala provon se ka marrë dajeni për shkakun e rishikimit. Në rastet e parashikuara në nenin 495, afati prej 30 ditësh fillon nga dita që vendimi ka marrë formën e prerë.”

10. Neni 497 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se:

“1. Kërkesa për rishikim paraqitet para gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, por në rast se vendimi është ankimuar në gjykatat më të larta, kompetente është gjykata më e lartë që ka shqyrtuar çështjen në themel. Gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rishikim gjykon sipas rregullave të zbatueshme për atë shkallë gjykimi. Kërkesa duhet të përmbajë: shkakun për të cilin kërkohet rishikimi, provat përkatëse që lidhen me një nga kërkesat e nenit 494, të këtij Kodi, ditën e zbulimit ose të vërtetimit të rrethanës ose marrjes së dokumenteve.

2. Kërkesa nënshkruhet nga avokati i pajisur me prokurë dhe nëse pala e kërkon, edhe nga kjo e fundit.

3. Kërkesa e paraqitur pa u plotësuar ose në kundërshtim me kriteret e mësipërme kthehet për plotësim nga gjykata. Në rast se kërkesa nuk plotësohet brenda një afati 10-ditor, gjykata vendos mospranimin e saj.”

11. Neni 498 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se:

“1. Kur kërkesa është bërë jashtë rasteve të përcaktuara në nenin 494 ose kur është bërë nga ata që nuk e kanë këtë të drejtë, si dhe kur rezulton haptazi e pambështetur, gjykata vendos mospranimin e saj.

2. Kur kërkesa shqyrtohet nga gjykata e shkallës së parë ose gjykata e apelit dhe pranohet, gjykata vendos prishjen e vendimit tërësisht ose pjesërisht dhe vazhdon gjykimin e çështjes në themel.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT TIRANË

3. Kur kërkesa shqyrtohet nga Gjykata e Lartë dhe pranohet prej saj, gjykata vendos prishjen e vendimit tërësisht ose pjesërisht dhe e dërgon atë për rigjykim në gjykatën kompetente, e cila e gjykon me një tjetër trup gjykues. Nëse shkak i rishikimit nuk lidhet me nevojën e saktësisimit të fakteve të reja, Gjykata e Lartë revokon vendimin e mëparshëm të saj dhe vendos sërish për çështjen, sipas kompetencave të saj.

4. Në rastin e përcaktuar nga shkronja "e", e nenit 494, të këtij Kodi, gjykata kompetente prish vendimin e dytë.

5. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit lejohet ankim ose rekurs në gjykatën më të lartë, sipas rregullave të përgjithshme të ankimit ose rekursit.

6. Në rast se kërkesa shqyrtohet nga Gjykata e Lartë, kundër vendimit të saj nuk lejohet ankim."

IV. Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

12. Gjykata e Apelit Tiranë vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesit Ramazan Dervishi, Sinan Dervishi, Ramiz Dervishi, Fatime Dervishi, Luan Llapaj, Bukurije Llapaj, Dhurata Llapaj, Bruno Llapaj, Olban Llapaj, për rishikimin e vendimit nr.12910, datë: 23.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.3891, datë: 01.12.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, është e pabazuar në ligj e në prova e si e tillë nuk mund të pranohet.

13. Kërkuesit pretendojnë para gjykatës si shkak të rishikimit të vendimeve nr.12910, datë: 23.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.3891, datë: 01.12.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, faktin se nuk kanë pasur dijeni për VKM nr.1283, datë: 23.12.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.195 vitit 2009 (faqe 8668), sipas të cilës atyre u është miratuar legalizimi i parcelave ndërtimore informale. Në lidhje me këtë, gjykata vëren se neni 494(a) i Kodit të Procedurës Civile lejon paraqitjen e mjetit të jashtëzakonshëm të goditjes së vendimeve që përbëjnë gjë të gjykuar, vetëm nëse "zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të diheshin nga pala gjatë shqyrtimit të saj". Pyetja që shtrohet në këtë gjykim është: A përbën fakt të ri apo provë të re shkresore Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1283, datë: 23.12.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.195 vitit 2009 (faqe 8668)?

14. Gjykata vëren se Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë është akti zyrtar për publikimin e ligjeve dhe akteve të tjera që Kushtetuta dhe ligji parashikon shprehimisht se botohen në këtë fletore. Kjo do të thotë se botimi në Fletoren Zyrtare i akteve të ndryshme juridike, bëhet me qëllim për të njoftuar të gjithë subjektet e së drejtës në lidhje me përmbajtjen e këtyre akteve. Dijenia e personave të ndryshëm për aktet e botuara në Fletore Zyrtare, është prezumim ligjor *quasi* absolut, i cili nuk mund të rrëzohet me pretendimin se nuk e kam lexuar Fletoren Zyrtare. Pra, prezumohet dijenia e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT TIRANË

subjekteve për aktet e publikuara në Fletoren Zyrtare me përjashtimin e vetëm të rasteve kur mosnjohja është objektivisht e paevitueshme. Barra e provës për të provuar se kërkuesit e kishin objektivisht të pamundur të konsultoheshin me Fletoret Zyrtare, apo të interesoheshin pranë ALUIZNI-t, i përket kërkuesve, të cilët nuk paraqiten asnjë provë në këtë drejtim. Vlen të theksohet se rastet kur një fakt i botuar në Fletoren Zyrtare është objektivisht i pamundur të dihet për një shtetas Shqiptar, janë p.sh: kur ky shtetas ka qenë në koma mjekësore gjatë gjithë kohës, ose në kushte të ngjashme me këto raste. Rrjedhimisht, kërkuesit Ramazan Dervishi, Sinan Dervishi, Ramiz Dervishi, Fatime Dervishi, Luan Llapaj, Bukurije Llapaj, Dhurata Llapaj, Bruno Llapaj, Olban Llapaj, nuk mund të pretendojnë si shkak për rishikim, mosnjohjen nga ana e tyre të një VKM-je, të dalë në favor të tyre. Kjo është krejtësisht e pamundur në rastin konkret dhe ky pretendim i kërkuesve është në kufijtë e paraqitjes së një kërkese abuzive në gjykatë, në kuptim të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile (*të ndryshuar*).

15. Gjykata e apelit thekson se procesi gjyqësor është një aktivitet serioz procedural, në të cilin vërtetohen fakte me rëndësi për përcaktimin e të drejtave të palëve. Subjekti që vlerëson të mos marrë pjesë në një gjykim ku mund të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e tij ndaj të tjerëve, duke e lënë gjykimin në mungesë (*ndonëse është njoftuar rregullisht*), apo duke mos ngritur fakte e pretendime të cilat kishin detyrimin dhe mundësinë t'i dinte, humb të drejtën e ngritjes në procese të tjera të pretendimeve që mund dhe duhej të ngrinte në atë gjykim. Shkeljet procedurale të një gjykimi të caktuar, nuk kontrollohen në gjykime të tjera të reja, por kontrollohen nëpërmjet rrugëve të zakonshme të ankimit në atë proces, përfshirë këtu rekursin në Gjykatën e Lartë, të cilin palët që pretendojnë cenimin e të drejtave të tyre, kanë të drejtën dhe detyrimin ta ushtrojnë. Vendimi i gjykatës që e zgjidh çështjen në themel dhe merr formë të prerë, ka fuqinë e ligjit dhe është i detyrueshëm jo vetëm për palët, por edhe për të gjithë subjektet shtetërore, përfshirë edhe gjykatat e tjera (*neni 451/a i Kodit të Procedurës Civile*). Asnjë padi e zakonshme, brenda sistemit të zakonshëm gjyqësor, nuk mund të zhbëjë një vendim gjyqësor të formës së prerë, nëse pretendohen fakte apo rrethana që dihen ose duhet të dihen gjatë kohës së zhvillimit të gjykimit, e që me vetëdije nuk i janë paraqitur gjykatës nga palët ndërgjyqëse. Nga ky rregull ka dy përjashtime shumë strikte, që lidhen ose me rastet kur gjen zbatim instituti i rishikimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*si mjet i jashtëzakonshëm ankimi*), ose me rastin kur gjen zbatim instituti i pavlefshmërisë së titujve ekzekutivë (*si mjet mbrojtje në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm*).

16. Instituti i rishikimit të vendimeve të formës së prerë, është mjeti i jashtëzakonshëm i ankimit kundrejt këtyre vendimeve dhe lejohet të paraqitet në gjykatë, vetëm brenda kushteve dhe kritereve të përcaktuara taksativisht



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E APELIT TIRANË

nga neni 494 i Kodit të Procedurës Civile. Barrën e provës për të provuar rastet e parashikuara nga ky nen, e ka kërkuesi. Rasti (a) i nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, që lidhet me situatën kur zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të diheshin nga pala gjatë shqyrtimit të saj (*pra fakte që ekzistonin para se të niste apo gjatë gjykimit, por që nuk diheshin nga pala*), nënkupton barrën e të provuarit të kërkuetit se rrethanat apo provat e reja shkrese jo vetëm nuk i dinte në kohën e zhvillimit të gjykimeve (*të cilat janë mbyllur me vendime të formës së prerë*), por as nuk mund të diheshin prej kësaj pale, për shkak të pamundësisë absolute të marrjes dijëni për to. Pra, edhe nëse pala do të bënte përpjekjet maksimale të një njeriu mesatar, për të marrë dijëni për rrethanat apo provat shkrese, ai do ta kishte të pamundur të merrte dijëni për to. Në këtë kontekst, kuptohet qartë se marrja dijëni për Fletoren Zyrtare nr.195, të vitit 2009, ishte një gjë tepër e lehtë për kërkuetit, e cila ishte plotësisht e mundur të bëhej prej tyre, aq më tepër kur VKM-ja në fjalë, trajtonte problematikat e legalizimit që ata vetë kishin parashtruar para ALUIZNI-t. Mosdijënia e pretenduar nga kërkuetit, është justifikim i pambështetur në ligj e në prova, për të paraqitur kërkesën për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Edhe në rastin ekstrem që pranohet se kërkuetit nuk kishin dijëni për VKM-në e mësipërme, prapë se prapë ata nuk mund të kërkojnë rishikimin e vendimeve, pasi nuk provohet se kanë qenë në pamundësi të bëjnë përpjekjet minimale të nevojshme (*konsultimi në faqen zyrtare në internet të Qendrës së Botimeve Zyrtare, apo interesimin pranë zyrove të ALUIZNI-t*) për të marrë dijëni për këtë fakt të botuar në Fletoren Zyrtare. Në këtë kontekst, gjykata e apelit vëren se kërkuetit kanë orientuar gabim kërkimet e tyre, duke paraqitur kërkesë për rishikim.

17. Në përfundim, në kushtet kur pala kundërshtare me kërkuetit Dervishi dhe Llapaj, shtetasit Ilir Gavoçi dhe Aleksandër Gavoçi, nëpërmjet avokatëve të tyre i bënë me dije gjykatës se ka të dhëna se pas dhënies së vendimeve palët kanë arritur marrëveshje me njëra-tjetrën, duke lëshuar kreditorët Gavoçi edhe deklarata noteriale për heqjen dorë nga ekzekutimi i titujve ekzekutivë (*objekt rishikimi në këtë gjykim*), atëherë ky fakt rezulton se është i ngjarë pas dhënies së vendimeve dhe për të palët e interesuara duhet të referojnë tek paragrafi i dytë i nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit "*Kur titulli ekzekutiv është një vendim gjyqësor ose vendim arbitrazhi, debitori mund të kundërshtojë ekzekutimin e titullit vetëm për fakte të ngjara pas dhënies së këtyre vendimeve.*" Gjykata e apelit thekson se çështjet e pavlefshmërisë së titujve ekzekutivë vendimit nr.12910, datë: 23.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.3891, datë: 01.12.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak të "faljes" së detyrimit të bërë nga kreditorët Gavoçi ndaj debitorëve Dervishi e Llapaj, pas marrjes formë të prerë të vendimeve, nuk janë objekt gjykimi në këtë proces që ka për objekt rishikimin e këtyre vendimeve, por duhet të zgjidhen nga palët në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT TIRANË

gjykimin e posaçëm sipas nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile. Mirëpo, meqenëse pala Gavoçi e përmendi si fakt para gjykatës dhe solli prova të tërthorta në këtë drejtim, gjykata vlerëson të përshtatshme të sqarojë për palët se instituti i pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv, është mënyra e vetme e zhbërjes së një titulli ekzekutiv (vendim gjyqësor) dhe në dallim nga kërkesa për rishikim, pavlefshmëria e titujve ekzekutivë mund të kërkohet vetëm për fakte të ngjara pas dhënies së vendimeve të formës së prerë.

Për keto arsye:

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata e Apelit Tiranë, bazuar në nenin 498(1) të Kodit të Procedurës Civile,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e kërkesës për rishikim të vendimit nr.12910, datë: 23.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.3891, datë: 01.12.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë, brenda 30 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.